



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bordi i Administrimit

Nr. 1235 Prot

Shkodër, më 25. 03 2025

**VENDIM**

Nr. 102, datë 25 . 03 2025

**Për përcaktimin e kodit përkatës dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit i ciklit të dytë, "Master i Shkencave" në "Marketing Inovativ", në Fakultetin Ekonomik, USH, Departamenti i Turizmit, për vitin akademik 2025- 2026, aplikuar për hapje pranë MAS"**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38. pika 1, gërma "dh"; neni 80; Vendimi nr. 310, datë 11. 05. 2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 8; Udhëzimin e MAS nr. 2, datë 21. 01. 2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e Kreut IV/A, gërma a); në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" neni 17, pika 6, gërma f); Vendimi i Senatit Akademik të USH-së nr. 261, datë 21. 11. 2024 "Për miratimin e disa programve të studimit për vitin akademik 2025-2026"; Shkresën e Fakultetit Ekonomik, nr. 377/1 prot., datë 21. 03. 2025, protokolluar në Rektorat me nr.1199, datë 21.03.2025, Skeda kodifikuese e programit të Studimit Master i Shkencave në "Marketing Inovativ", me vendim të Senati Akademik, nr.99 të datës 25. 03. 2025, Bordi i Administrimit me vendim qarkullues të datës 25.03.2025 me shumicë votash

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kodit dhe gjuhës në të cilën do të zhvillohet programi i studimit, në kuadër të aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Marketing Inovativ", në Fakultetin Ekonomik, USH, Departamenti i Turizmit, për vitin akademik 2025- 2026, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Gjuha në të cilën do të zhvillohet ky program studimi do jetë **“Gjuha Shqipe” (S)**; Kodi i programit të Studimit është **72MS0311S**.
3. Ky vendim të ngarkohet në portalin e- Albania, për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Bordit të Administrimit**

**Prof. Asoc.Dr. Adrian LEKA**



## SKEDË PËR KODIFIKIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

|                                                                      |                                                                                        |
|----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>FAKULTETI EKONOMIK</b>                                            |                                                                                        |
| <b>DEPARTAMENTI TURIZËM</b>                                          |                                                                                        |
| Emërtimi i Programit të studimit                                     | Marketing Inovativ                                                                     |
| Niveli i programit të studimit sipas Komizës                         | 7                                                                                      |
| Shqiptaro të Kualifikimit                                            |                                                                                        |
| Kohëzgjatja e programit të studimit                                  | 2                                                                                      |
| Lloji i programit të studimit                                        | Master shkencor                                                                        |
| Fusha e detajuar ku bën pjesë programi i studimit                    | 0311                                                                                   |
| Gjuha e programit të studimit                                        | S                                                                                      |
| Argumentimi lidhur me kodin që duhet të përmbajë programi i studimit | Programi i studimit master shkencor "Marketing Inovativ" i klasifikohet 0311 "Ekonomi" |
| Kodi i programit të studimit                                         | 72MS0311S                                                                              |

